



PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE

STATUTI

Qershor 2022

PËRMBAJTJA

I. Dispozitat e përgjithshme	3
II. Qëllimi dhe parimet kryesore të partisë	3
III. Venimmarrja dhe hierarkia e akteve	5
IV. Anëtarësia	6
V. Organizmi dhe funksioni i PLE-së.....	7
VI. Organizimi në nivel lokal.....	8
VII. Organizimi në nivel qendror.....	12
VIII. Përfaqëzimi i grave dhe të rinjëve	20
IX. Financimi dhe auditimi	21
X. Përfaqësimi në institucione.....	22
XI. Zgjidhja e kontesteve.....	23
XII. Kushtet në të cilat pushon veprimtaria e PLE-së	24
XIII. Dispozitat përfundimtare.....	24

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Partia Liberale Egjiptiane është parti politike e Egjiptianëve të Kosovës dhe qytetarëve të tjerë të cilët e pranojnë programin dhe statutin e partisë. Partia Liberale Egjiptiane angazhohet për ndryshime rrënjësore shoqërore dhe politike, duke u mbështetur në parimin e barazisë, të demokracisë, të lirisë politike dhe të drejtësisë sociale dhe ekonomike të çdo qytetari.

Neni 2

Emri i plotë i subjektit politik është Partia Liberale Egjiptiane.

- a. Akronimi i partisë është PLE.

Neni 3

- a. Selia qendrore e Partisë Liberale Egjiptiane është në Fushë Kosovë.
- b. Logoja e Partisë Liberale Egjiptiane është shenja me “Zogun e Lirisë” që është simbol liberal i demokratëve në botë. Logoja është e rrethuar me emrin e partisë, në mes do të përmbajë shkronjat PLE të mëdha, zogun e lirisë dhe hartën e Kosovës me ngjyrë të kaltër qielli e cila do të përdoret për të identifikuar Partinë Liberale Egjiptiane.
- c. Partia Liberale Egjiptiane ka vulën e saj. Vula është në formë rrethi me mbishkrim Partia Liberale Egjiptiane dhe në mes PLE. Çdo degë do të ketë vulën e vet të ngjashme me vulën kryesore, por do të dallohet në bazë të numrit rendor dhe emrit të degës.
- d. Çdo vendim dhe dokument tjetër që vulozet në emër të PLE-së duhet të mbahet evidencë nga Sekretari i PLE-së dhe Sekretari i Degës.
- e. Me autorizim të Kryetarit të PLE-së, Kryetarit të Degës i autorizohet përdorimi i vulës.

II. QËLLIMI DHE PARIMET KRYESORE TË PARTISË

Nenin 4

1. Partia Liberale Egjiptiane është parti e themeluar ne bazë të gjitha parimeve demokratike që ka për qëllim të ushtroj veprimtarinë e saj demokratike në nivel qendror dhe lokal.
2. Partia Liberale Egjiptiane është parti e hapur për bashkëpunim me të gjitha subjektet tjera politike të certifikuara në Kosovë, në pajtim me sistemin e së drejtës dhe të gjitha mjetet tjera demokratike si dhe me partitë e tjera jashtë Kosovës.
3. Partia Liberale Egjiptiane do të kujdeset që të ndërtoj një shoqëri demokratike, të promovoj zhvillimin ekonomik, t'i adresoj problemet sociale dhe kulturore të komunitetit Egjiptian, të promovoj edukimin institucional, të angazhohet në mënyre

demokratike dhe në pajtim me ligjin kundër çdo forme të diskriminimit ndaj komunitetit Egjiptian në Republikën e Kosovës, integrimin e komunitetit Egjiptian në Kosovë dhe jashtë saj, të punoj në kthimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë.

4. Liria e zgjedhjes dhe respektimi i votës së lirë janë parime individuale të garantuara nga Partia Liberale Egjiptiane.
5. Partia Liberale Egjiptiane mbron të gjithë anëtarët e saj, të drejtën e mendimit të lirë dhe të drejtën e fjalës. Partia do të promovoj masa të barabarta për të gjithë pa dallim të etnisë, religjionit, ngjyrës, gjinisë, moshës për çdo individ që plotëson kriteret për anëtarësim dhe që e pranon statutin dhe programin e saj mund t'i bashkëngjitet partisë.
6. Transparenca dhe informimi rreth programit partiak dhe aktivitetet do të jetë gjithëpërfshirëse, në gjuhë të thjeshtë dhe lehtë të kuptueshme.

Neni 5

1. Partia Liberale Egjiptiane përfshinë dhe promovon të drejtat dhe liritë themelore të parapara në Deklaratën Universale për te Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare të Drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe konventave të tjera ndërkombëtare dhe regjionale me karakter të ngjashëm si dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. *Të zhvilloj aktivitete të bashkëpunimit me të gjitha komunitetet në Kosovë, në mënyrë më të veçantë me komunitetin Ashkali. Ndërmarr veprime konkrete në përafrimin e komunitetit Egjiptian dhe atij Ashkali për të ndikuar në unifikimin e veprimeve të këtyre dy komuniteteve.*
3. Të punoj me subjekte politike, komunitete të tjera dhe organizata me të cilat ndajmë vlera të përbashkëta apo kanë ngjashmëri programore me Partinë Liberale Egjiptiane.
4. Të angazhohet në iniciimin dhe promovimin e demokracisë në mes të popujve që jetojnë në Kosovë dhe jashtë saj.
5. Të punohet drejt integritit në tërësi të komunitetit Egjiptian me shtetësi të Republikës së Kosovës dhe thellimin e bashkëpunimit me komunitetin egjiptian jashtë Kosovës.
6. Të ndihmoj Kosovën në integrimet evropiane dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtar.
7. Të ndihmoj në eliminimin e tërësishëm të getoizimit të egjiptianëve në Kosovë.
8. Të ndihmoj, fuqizoj dhe inkurajoj të rinjtë egjiptian që të jenë në gjendje të avancohen në pozita të ndryshme ekzekutive dhe politike në institucionet e Republikës së Kosovës, shoqërisë civile dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare në botë.

9. Të ndihmoj në krijimin e një strukture të fuqishme lobiste në botë për fuqizimin e komunitetit egjiptian.
10. Të bashkëpunoj me komunitetet tjera etnike dhe komunitetin shumicë në Kosovë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.
11. Të koordinoj dhe të angazhoj ekspertë dhe këshilltarë të komunitetit egjiptian nëpër botë për të fuqizuar komunitetin brenda dhe jashtë Kosovës.
12. Të ndihmoj në organizimin e teorive, mendimeve, dhe publikimeve shkencore që ka të bëjë me historinë e komunitetit dhe hulumtimin e mëtutjeshëm të prejardhjes etnike.
13. Të punoj dhe bashkëpunoj me organizatat tjera politike brenda dhe jashtë Kosovës simotra me orientime të demokracisë liberale.
14. Të anëtarësohet në asociacione të ndryshme ndërkombëtare me orientime të demokracisë liberale.
15. Të zhvilloj politika të mirëfillta për një jetë më të dinjëtetshme për komunitetin Egjiptian të Kosovës.

III. VENIMMARRJA DHE HIERARKIA E AKTEVE

Vendimmarrja

Neni 6

1. Forma e votimit në organin përkatës të PLE-së zbatohet në pajtim me Statutin dhe aktet tjera nënligjore nga organi kompetent për vendosjen e çështjeve përkatëse.
2. Procesi i vendimmarrjes brenda organeve të PLE-së merret me shumicë të thjeshtë votash (50%+1) në mbledhjet që e përmbushin kuorumin (50%+1) të anëtarëve që e përbëjnë organin përkatës. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë vetëm rastet e specifikuara ndryshe brenda këtij Statuti.
3. Votimi mund të bëhet në formë të hapur dhe të mbyllur. Për formën e votimit mund të vendosin anëtarët e organit përkatës me shumicën e votave të anëtarëve prezent.

Hierarkia e akteve

Neni 7

1. Akti më i lartë i partisë është Statuti i cili duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe të gjitha ligjet tjera të Republikës së Kosovës.

2. Fuqi me te vogël juridike që vijnë menjëherë pas statutit kanë këto akte juridike:
 - a. Rregullore;
 - b. Vendime;
 - c. Udhëzime.

IV. ANËTARËSIA

Neni 8

1. Anëtarë i partisë mund të bëhet çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeçare, që ka të drejtë për të zgjedhur, dhe që pranon programin dhe Statutin e PLE-së.
2. Anëtarësimi bëhet përmes nënshkrimit të një deklarate me shkrim në mënyrë individuale në degët e PLE-së, apo përmes plotësimit të formës elektronike të regjistrimit.
3. Anëtari duhet të pajiset me librezën e anëtarësisë së PLE-së.
4. Anëtari i PLE-së nuk mund të jetë edhe anëtar i ndonjë partie tjetër apo të kandidojë në listën e ndonjë subjekti tjetër politik.
5. Udhëheqësit e organizatave jo qeveritare nuk mund të jenë anëtarë të PLE-së.
6. Anëtari i partisë ka të drejtë pjesëmarrje në organizimin, përcaktimin dhe zbatimin e politikave të partisë në format e parapara me këtë statut dhe në pajtim me të gjitha aktet tjera ligjore dhe nënligjore.
7. Anëtari ka të drejtë të zgjedh dhe të zgjidhet në organet e partisë. Të veprojnë aktivisht në të, të zgjidhet në organet dhe format e organizimit të partisë, të kandidohet për zgjedhje në listat e PLE-së.
8. Nëse anëtari i PLE-së e ndërron vendbanimin, ushtrimin e aktivitetit të tij e bënë në degën apo nëndegën në të cilën e ka adresën e re të banimit.
9. Pagesa e anëtarësisë në parti mund të bëhet në shumën e përcaktuar nga Kryesia e partisë përmes një vendimi të veçantë.
10. Partia Liberale Egjiptiane mbanë evidencë për anëtarët, simpatizantët dhe mbështetësit e partisë. Degët e partisë mbajnë evidencat e anëtarëve të tyre, përderisa Kryesia mbanë evidencën e të gjithë anëtarëve të partisë .
11. Simpatizant të partisë konsiderohen të gjithë ata që nuk janë të anëtarësuar në PLE por që i mbështesin politikën dhe programin e Partisë Liberale Egjiptiane.
12. Mbështetës të partisë konsiderohen të gjithë ata persona fizik dhe juridik të cilët i japin kontribut partisë qoftë me mjete financiare po ashtu edhe kontribute të tjera.

13. Anëtarët e partisë kanë të drejtë për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e PLEs-së si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksionet financiare.

Humbja e anëtarësisë

Neni 9

1. Çdo anëtarë i PLE-së ka për obligim të respektoj Statutin dhe aktet e tjera juridike. Anëtarit mbanë përgjegjësi individuale për dhënien pa autorizim të deklaratave politike në emër të partisë, për mosrespektim të Kodit të Etikës të PLE-së, për keqpërdorim të mjeteve financiare dhe pasurisë në kundërshtim me aktet juridike të Partisë Liberale Egjiptiane të bazuara në Nenin 7 pika 2.
2. Statusi i anëtarit të PLE-së humbet në rast të përfshirjes në aktivitete që dëmtojnë rëndë imazhin e partisë, të cilat kanë të bëjnë me:
 - a. Cenim të parimeve dhe dokumenteve themeltare të PLE-së;
 - b. Pjesëmarrjes në aktivitete dhe ideologji që nxitin urrejtje ndëretnike;
 - c. Përfshirjes në keqpërdorim të fondeve dhe abuzim me detyrën zyrtare në parti apo në institucione shtetërore;
 - d. Përfshirja në aktivitete që sabotojnë dhe komplotojnë kundër PLE-së;
 - e. Shpërndajnë informata konfidenciale dhe të pa autorizura të PLE-së.
3. Vendimin për humbjen e statusit të anëtarit të PLE-së për rastet e parapara në Nenin 9 e merr Kryesia e Degës së PLE-së në të cilën anëtarit është i anëtarësuar.
4. Personi i përjashtuar ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh, pas vendimit për përjashtim. Ankesën mbi vendimin për përjashtim e shqyrton Komisioni i Shkallës së Dytë, i formuar nga ana e Kryesisë së PLE-së.
5. Anëtarit i PLE-së mund të jap dorëheqje nga anëtarësia. Për aktin e dorëheqjes duhet të informoj me shkrim Kryesinë e Degës, *përfshirë arsyet konkrete të dorëheqjes përmes një akti zyrtar.*

V. ORGANIZMI DHE FUNKSIONI I PLE-SË

Neni 10

1. Partia Liberale Egjiptiane organizohet dhe vepron përmes degëve të saj edhe jashtë territorit të Kosovës në përputhshmëri me ligjet e shtetit përkatës dhe atyre të aplikueshme në Kosovë.
2. PLE është e organizuar në dy nivele, atë lokal dhe qendror.
3. Në nivel lokal të organizimit, strukturat e PLE-së përbëhen nga dy nën nivele.
4. Nën-niveli i parë përbëhet nga organet si në vijim:

- a. Kuvendi i Nëndegës;
 - b. Kryesia e Nëndegës;
 - c. Kryetari i Nëndegës;
5. Nën-niveli i dytë përbëhet nga organet si në vijim:
- a. Kuvendi i Degës;
 - b. Kryesia e Degës;
 - c. Sekretari i Degës.
 - d. Kryetari i Degës;
6. Në nivelin qendror të organizimit, strukturat e PLE-së përbëhen nga:
- a. Kuvendi i PLE-së;
 - b. Kryesia Qendrore e PLE-së;
 - c. Sekretari i Përgjithshëm i PLE-së.
 - d. Kryetari i PLE-së;
7. Në nivel interpretues dhe disiplinor, PLE ka:
- a. Komisionin Statutor.
 - b. Komisionin i Etikës.
8. Në nivel të organeve këshilluese, PLE ka këtë strukturë:
- a. Instituti Hulumtues i PLE-së ;
 - b. Grupi i grave;
 - c. Grupi i të rinjve.
 - d. Grupi i ndërmjetësimit.
9. PLE-ja sipas nevojës mund të vendos edhe për organe të tjera duke vlerësuar dhe vendosur në Kryesi.

VI. ORGANIZIMI NË NIVEL LOKAL

Nëndega

Neni 11

1. Nëndega është njësia themelore e organizimit të PLE-së.
2. Nëndegët e PLE-së formohen në nivel të qyteteve, fshatrave dhe lokaliteteve të caktuara.
3. Numri i delegatëve të Kuvendit të Nëndegës caktohet në varësi të numrit të anëtarëve të PLE-së në atë Nëndegë, përmes një vendimi të veçantë të Kryesisë së Degës, i cili bazohet në këtë këto kritere:
 - a. Prezenca e komunitetit egjiptian në atë lokalitet sipas regjistrimit civil;
 - b. Numri i votave të fituara në atë lokalitet në zgjedhjet e fundit.

4. Në Nëndegën që ka më pak se 100 anëtarë, Kuvendin e Nëndegës e përbëjnë të gjithë anëtarët e saj.
5. Në Nëndegën që ka më shumë se 100 anëtarë, Kuvendin e Nëndegës e zgjedh Kuvendi zgjedhor i Nëndegës në mesin e delegatëve të saj.
6. Anëtarët e Kuvendit të Nëndegës në mesin e tyre zgjedhin Kryesinë e Nëndegës, Kryetarin e Nëndegës dhe delegatët në Kuvendin e Degës.
7. Përfaqësimi i nëndegëve në Kuvendin e Degës bëhet jo më pak se 3 delegatë dhe jo më shumë se 5 delegatë për secilën Nëndegë.
8. Kuvendi i Nëndegës zgjedh Kryetarin dhe Kryesinë e Nëndegës.
9. Kryesia e Nëndegës përbëhet prej 2 anëtarëve dhe Kryetari.

Dega

Neni 12

1. Degët janë njësi të organizmit dhe të veprimit territorial të PLE-së.
2. Degët mund të jenë njësi të organizimit në nivel të komunës, të disa komunave apo të një regjioni të caktuar.
3. Kryesia e PLE-së mund të propozojë themelimin e Degëve të reja dhe të kufijve të organizmit të tyre. Vendimin për themelimin e Degëve të reja, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, e merr Kryesia e PLE-së.
4. PLE ka shtatë Degë të cilat janë si në vijim:
 - a. Dega e Pejës;
 - b. Dega e Gjakovës;
 - c. Dega e Ferizajt;
 - d. Dega e Fushë-Kosovës;
 - e. Dega e Klinës;
 - f. Dega e Istogut;
 - g. Dega e Prizrenit;

Përiashtimisht paragrafit 4, PLE-ja mund të ketë njësi edhe në komuna të tjera në Kosovë varësisht nga kërkesat dhe nevojat e komunave përkatëse.

Deri në formimin e degës, këto njësi do të jenë të përfaqësuara në të gjitha strukturat e PLE-së me 20% të anëtarëve të asaj njësie për dallim prej të drejtës së plotë të degës së rregullt që përfaqësohet me 100% të anëtarëve të asaj dege.

Forma dhe organizimi i njësive do të rregullohet me një akt të veçantë i nxjerrur në kryesinë e PLE-së.

5. PLE mund të ketë Degët e saja të cilat veprojnë jashtë vendit. Themelimi i këtyre degëve bëhet në pajtim me statutin e PLE-së Degët e PLE-së jashtë vendit, krahas respektimit të Statutit, Programit dhe rrequllave tjera të brendshme të partisë, respektojnë edhe legjislacionin e vendit përkatës.
6. Degët që veprojnë jashtë vendit propozojnë nga një anëtarë për t'i përfaqësuar në Kryesinë Qendrore të PLE-së.
7. Në pamundësi të pjesëmarrjes fizike në mbledhjet e Kryesisë së PLE-së, përfaqësuesit e degëve nga jashtë mund të lidhen përmes vidokonferencave, të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë përmes formës elektronike.

Kuvendi i Degës

Neni 13

1. Kuvendin e Degës e përbëjnë delegatët e zgjedhur në Kuvendet e nëndegëve.
2. Në Kuvendin e Degës, delegatët duhet të jenë të përfaqësuar nga të gjitha Nëndegët jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 5 delegatë.
3. Kuvendi i punës së Degës mbahet të paktën një herë në vit.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Degës mbahet nëse këtë e kërkon:
 - a. Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit;
 - b. Kryetari i Degës;
 - c. Kryesia e Degës.
5. Kompetencat e Kuvendit të Degës janë:
 - a. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Degës;
 - b. Zgjedh dhe shkarkon Kryesinë e Degës;
 - c. Zgjedh delegatët në Kuvendin e Përgjithshëm të PLE-së;
 - d. Propozon anëtarët e Kryesisë Qendrore të PLE-së;
 - e. Miraton vendime te obligueshme për Kryesinë e Degës;
 - f. Shqyrton dhe miraton Planin e Punës së Kryesisë;
 - g. Shqyrton Raportin Financiar të Degës;
 - h. Thërret në raportim të zgjedhurit dhe të emëruarit nga radhët e PLE-së në institucionet publike, në nivel qendror dhe lokal.

Kryesia e Degës

Neni 14

1. Kryesia e Degës është organ politiko-ekzekutiv i Degës dhe ka për obligim të zbatoj vendimet e Kuvendit të Degës dhe të organeve më të larta të PLE-së.
2. Kryesinë e Degës e përbëjnë të gjithë kryetarët e zgjedhur të Nëndegëve.

3. Zgjedhja e përfaqësuesve të Nëndegës në Kryesinë e Degës bëhet në Kuvendin e Nëndegës.
4. Mbledhjet e Kryesisë së Degës i thërret dhe i udhëheq Kryetari i Degës.
5. Mbledhjet e Kryesisë së Degës mund të mbahen edhe me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të Kryesisë së Degës.
6. Kompetencat e Kryesisë së Degës janë:
 - a. Kujdeset për funksionimin e Degës, në pajtim me Statutin, ligjet dhe të gjitha aktet tjera të brendshme;
 - b. Zgjedh dhe shkarkon dy nënkryetarët e Degës me propozim të Kryetarit të Degës;
 - c. Zgjedh dhe shkarkon Sekretarin e Degës, me propozim të Kryetarit të Degës;
 - d. Zgjedh dhe shkarkon Zyrtarin Financiar të Degës, me propozim të Kryetarit të Degës;
 - e. Kujdeset për zbatimin e të gjitha akteve të PLE-së;
 - f. Bashkëpunon me të gjitha degët dhe nëndegët tjera;
 - g. Kryesia e Degës i raporton Kuvendit të Degës për punën dhe aktivitetin e vet;
 - h. Në koordinim me Kryetarin e PLE-së, vendos për lidhjen e koalicioneve parazgjedhore dhe paszgjedhore me subjekte të tjera politike në nivel të komunës.
7. Kryesia e Degës mbledhet së paku një herë në muaj dhe sipas nevojës mund të takohen edhe më shpesh. Njoftimi për mbledhje duhet të dërgohet më së largu tre ditë para datës së mbajtjes së mbledhjes.

Kryetari i Degës

Neni 15

1. Kryetari i Degës zgjidhet në mesin e anëtarëve të Kuvendit, me shumicë të votave me votim të fshehtë.
2. Kandidat për Kryetar të Degës duhet të jetë anëtar i PLE-së.
3. Kandidimi për kryetar bëhet në Kuvend të Degës. Kandidatët për kryetar mund të vet-propozohen.
4. Kryetari i Degës është anëtar i Kuvendit të Degës dhe i Kryesisë së Degës.
5. Kompetencat e Kryetarit të Degës janë:
 - a. Përfaqëson Degën në pajtim me Statutin dhe Programin e PLE-së;

- b. Thërret Kuvendin e Degës;
- c. Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kryesisë së Degës;
- d. Kujdeset për zbatimin e vendimeve të organeve më të larta të PLE-së, të Kuvendit dhe të Kryesisë së Degës;
- e. I propozon Kryesisë kandidatët për Nënkryetar, Sekretar dhe Zyrtar Financiar të Degës;
- f. Bashkërendit punët me nëndegët.

VII. ORGANIZIMI NË NIVEL QENDROR

Kuvendi i PLE-së

Neni 16

1. Kuvendi i PLE-së është organi më i lartë vendimmarrës i PLE-së.
2. Kuvendi i PLE-së përbëhet nga delegatët e zgjedhur në kuvendet e degëve.
3. Degët që veprojnë brenda vendit përfaqësohen në Kuvend me nga 15 delegatë të zgjedhur në kuvendet e degëve.
4. Degët që veprojnë jashtë vendit përfaqësohen në Kuvend me nga 3 delegatë të zgjedhur në kuvendet e degëve.
5. Nga numri i përgjithshëm i delegatëve të zgjedhur nga degët, të paktën 20% duhet të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar.
6. Kuvendi mund të jetë Zgjedhor dhe Kuvend Pune.
7. Kuvendi zgjedhor është kuvend i rregullt dhe thirret çdo katër vjet.
8. Kuvendi i Punës organizohet sipas nevojës ose së paku një herë ndërmjet dy kuvendeve zgjedhore.
9. Kuvendin e PLE-së e thirret Kryetari i PLE-së.
10. Rendin e ditës për Kuvendin zgjedhor dhe të jashtëzakonshëm e përcakton Kryesia e PLE-së.
11. Kuvendin e udhëheq Kryesia e punës së Kuvendit e cila zgjidhet nga Kuvendi dhe ka mandat vetëm atë sa zgjasin punimet e Kuvendit .
12. Kryesinë e punës së Kuvendit e përbëjnë kryetarët e Degëve.

Kompetencat e Kuvendit të PLE-së

Neni 17

1. Kuvendi i PLE-së ka kompetencat si në vijim:
 - a. Përcakton orientimet kryesore të PLE-së;
 - b. Analizon punën e PLE-së për periudhën në mes të dy kuvendeve;
 - c. Nxjerrë vendime, rekomandime, deklarata dhe rezoluta;
 - d. Miraton, ndryshon dhe plotëson Statutin e PLE-së;
 - e. Miraton, ndryshon dhe plotëson programin e PLE-së;
 - f. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e PLE-së;
 - g. Miraton anëtarët e Kryesisë së PLE-së, pas propozimeve të kuvendeve të degëve;
 - h. Shqyrton dhe miraton raportet financiare të PLE-se;
2. Kuvendi i PLE-së formon komisione punuese si:
 - a. Komision verifikues dhe i votimit;
 - b. Komisione te tjera sipas nevojës.

Kuvendi i Jashtëzakonshëm

Neni 18

1. Kuvendi i jashtëzakonshëm i PLE-se thirret në rastet si në vijim:
 - a. Ka shkelje të rënda Statutore ose programore nga ana e udhëheqësve të PLE-së;
 - b. Shpallen zgjedhje të jashtëzakonshme të PLE-së.
2. Kuvendin e Jashtëzakonshëm mund ta thërras edhe:
 - a. 1/3 e anëtareve të Kuvendit;
 - b. Kryesia e PLE-së;
 - c. Shumica e degëve të PLE-së;
 - d. Kryetari i PLE-së.

Kryesuesi i Kuvendit

Nenin 19

1. Kryesuesi i Kuvendit propozohet në mesin e delegatëve të Kuvendit.
2. Kryesuesi zgjidhet nga Kuvendi me shumicën e votave te anëtarëve të pranishëm.

Komisioni Statutar

Neni 20

1. Komisioni statutar funksionon në përputhje me rregulloren për organizmin dhe funksionimin e PLE-së.
2. Komisioni përbehet nga Kryetari i Komisionit statutar, Zëvendëskryetari dhe tre anëtarë të tjerë që i zgjedh Kryesia e PLE-së.
3. Anëtarë të Komisionit Statutar nuk mund të jenë:
 - a. Kryetari i PLE-së;
 - b. Anëtarët e komisioneve të tjera të PLE-së.
4. Kohëzgjatja, rizgjedhja dhe shkarkimi para mandatit të skadimit të komisionit është e njëjtë me mandatet e organeve të tjera të PLE-së.
5. Komisioni statutar përgatit për organet kompetente të PLE-së, propozon, prezanton dhe ju arsyeton në mënyrë profesionale miratimin e projekt-vendimeve dhe të gjitha akteve juridike të përgjithshme dhe të veçanta brenda partisë.
6. Komisioni jep mendim profesional për mos-ekzistimin e përputhshmërisë ndërmjet dispozitës së aktit juridik të përgjithshëm ose të aktit individual me dispozitën përkatëse të statutit të partisë.
7. Përcjell dhe zbaton dispozitat ligjore, krijon amendamente, të cilat organeve kompetente ju propozon me arsyetime profesionale për miratim.

Kryesia Qendrore e PLE-së

Neni 21

1. Kryesia e PLE-së është organ politiko-ekzekutiv i PLE-së.
2. Mandati i Kryesisë është katër vite.
3. Degët që veprojnë brenda vendit i propozojnë Kuvendit nga pesë anëtarë të Kryesisë. Në mesin e anëtarëve të propozuar, të pakën një duhet të jetë grua, dhe një i ri. Po ashtu anëtar të kryesisë duhet të jetë kryetari , nënkryetarët, sekretari dhe financieri. Nëse të njejitit zqjedhën jasht anëtarëve të kryesisë rritet numri i anëtarëve. Njësit e PLE-së përfaqësohen në kryesi me nga një anëtar.
4. Degët që veprojnë jashtë vendit i propozojnë Kuvendit nga një anëtarë të Kryesisë .
5. Për t'u propozuar për anëtar të Kryesisë, duhet pasur të përfunduar të pakëtën shkollimin e mesëm.
6. Numri i anëtarëve të Kryesisë së PLE-së mund të shtohet apo zvogëlohet në varësi të numrit të degëve dhe njësave.
7. Mbledhjet e Kryesisë mbahen të paktën çdo tre muaj. Sipas nevojës edhe më shpesh.

8. Mbledhjet i organizon Kryetari dhe Sekretari përmes formës me shkrim në afat kohor prej tre deri shtatë dite para datës së parapare të mbajtës së mbledhjes.
9. Mbledhjet e Kryesisë udhëhiqen nga Kryetari i PLE-së.
10. Vendimet në Kryesi merren me shumicën e votave të anëtarëve prezent në mbledhjet që përmbushin kuorumin.
11. Mbledhjet e jashtëzakonshme të PLE-së mund të thirren me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të Kryesisë.

Neni 22

1. Kryesia e PLE-së ka këto kompetenca:
 - a. Zgjedhë Nënkryetarët e PLE-së pas propozimit të Kryetarit;
 - b. Zgjedhë Sekretarin e PLE-së pas propozimit të Kryetarit apo të anëtarëve të Kryesisë së PLE-së;
 - c. Zgjedhë Përgjegjësinë Kryesor Financiar të PLE-së pas propozimit të Kryetarit apo të anëtarëve të Kryesisë;
 - d. Shkarkon anëtarët e Kryesisë së PLE-së me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve;
 - e. Miraton propozimet e degëve për zëvendësim të anëtarëve të Kryesisë Qendrore të PLE-së.
 - f. Nxjerrë rregullore dhe merr vendime;
 - g. Vendos për koalicione para dhe pas zgjedhore në nivel qendror;
 - h. Aprovon propozimin për programin dhe draft-statutin e partisë;
 - i. Përkujdeset për realizimin e detyrave të përcaktuar në Kuvendet përkatëse.

Kryetari i PLE-së

Neni 23

1. Paraqitja e kandidaturave për Kryetar të PLE-së bëhet në Kuvendin e PLE-së.
2. Për t'u kualifikuar si kandidat për Kryetar të PLE-së duhet përmbushur kriteret si në vijim:
 - a. Të jetë anëtar i PLE-së të pakën një vit para datës së kandidimit;
 - b. Të ketë të përfunduar të paktën shkollimin universitar;
 - c. Të jetë delegat i Kuvendit të PLE-së.
3. Votimi për zgjedhjen e Kryetarit të PLE-së është i fshehtë, me përjashtim kur në garë është vetëm një kandidat, për formën e votimit vendos Kuvendi.
4. Kryetari i PLE-së zgjedhet në Kuvendin e PLE-së me shumicën e votave të delegatëve prezent të PLE-së, në mbledhjet që përmbushin kuorumin.

5. Nëse ka më shumë se një kandidat dhe asnjëri prej tyre nuk arrin të marrë shumicën e votave të delegatëve të Kuvendit, dy kandidatët më të votuar shkojnë në raundin e dytë të votimit.
6. Kandidati i cili në raundin e dytë merr shumicën e votave të delegatëve të Kuvendit, zgjedhet Kryetar i PLE-së.
7. Mandati i kryetarit të PLE-së është 4 vite.

Shkarkimi i Kryetarit të PLE-së

Neni 24

1. Në rast të mos përmbajtjes së programit dhe Statutit, Kuvendi ka të drejtë të shkarkoj kryetarin e partisë para skadimit të mandatit.
2. Me propozimin e 1/3 së anëtarëve të Kuvendit, mund të ngrihet çështja e mosbesimit të Kryetarit.
3. Me votimin për shkarkim, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, pushon mandati i Kryetarit të PLE-së.
4. Kryetari mund të jep dorëheqje para skadimit të mandatit.
5. Në rast të mbetjes vakante të pozitës së Kryetarit, Kuvendi zgjedhor duhet të mbahet më së largu 30 ditë nga dita e votimit të suksesshëm të mosbesimit apo dorëheqjes së Kryetarit.
6. Në rast të dorëheqjes, pamundësie fizike apo vdekjes së kryetarit e zëvendëson njëri nga nënkryetarët për një periudhë jo më gjatë se 30 ditë, nga dita kur kryetari nuk mund ta ushroj funksionin e tij. Kryesia e PLE-së, me shumicë të thjeshtë të votave vendos se cili nga nënkryetarët e ushtron detyrën e kryetarit.

Kompetencat e Kryetarit të PLE-së

Neni 25

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të PLE-së janë si në vijim:
 - a. Përfaqëson partinë në pajtim me Statutin dhe Programin e PLE-së;
 - b. Udhëheq punën e partisë dhe organeve të përcaktuara me këtë statut;
 - c. Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit të Punës;
 - d. Udhëheqë punën e Kryesisë, në mungesë të tij mbledhjet e Kryesisë i udhëheq njëri prej nënkryetarëve sipas autorizimit të tij;
 - e. Për punën e tij i përgjigjet Kuvendit dhe Kryesisë së PLE-së;
 - f. Emëron dhe shkarkon këshilltarët e vet sipas nevojës. Mandati i këshilltarëve të Kryetarit zgjatë aq sa mandati i Kryetarit;

- g. Propozon personat për takime me subjekte juridike dhe propozon persona për stafin politik;
- h. Propozon shefin e shtabit zgjedhor;
- i. Propozon dhe nënshkruan marrëveshjet politike për koalicion, memorandum bashkëpunimi të partisë;
- j. Koordinohet me degët për lidhjen e koalicioneve para dhe pas zgjedhore në nivel të komunave.

Nënkryetarët

Neni 26

1. PLE do të ketë pesë nënkryetar të cilët do të mbulojnë një fushë të caktuar si në vijim:
 - a. Socio-ekonomike;
 - b. Shëndetësi;
 - c. Arsim;
 - d. Kulturë, Rini dhe Sport;
 - e. Diasporë.
2. Nënkryetarët i zgjedh dhe shkarkon Kryesia, me shumicë të votave të anëtarëve prezent, pas propozimit të Kryetarit.
3. Mandati i tyre zgjatë aq sa zgjatë mandati i Kryetarit.
4. Nënkryetarët për punën e tyre i përgjigjen Kryetarit dhe Kryesisë.
5. Nënkryetarët do të përfaqësojnë zbatimin e politikës dhe të gjitha programet tjera sipas propozimit të Kryetarit.

Sekretari

Neni 27

1. Njëri nga anëtarët e PLE-së zgjedhët në pozitën e Sekretarit.
2. Propozimet për Sekretarin e përgjithshme bëhen nga Kryetari i PLE-së apo anëtarët e Kryesisë.
3. Sekretari i përgjithshëm zgjedhet dhe shkarkohet nga Kryesia e PLE-së.
4. Sekretari për punën e tij i përgjigjet Kryetarit dhe Kryesisë.

Neni 28

1. Detyrat dhe kompetencat e Sekretarit të PLE-së janë si në vijim:
 - a. Mbikëqyrë zbatimin e politikës së përcaktuar nga Kryesia e PLE-së;

- b. I raporton Kryetarit dhe Kryesisë për punën dhe aktivitetet e degëve të PLE-së;
- c. Mirëmban arkivin e dokumentacionit dhe procesverbaleve gjatë punës së Kryesisë dhe Kuvendit;
- d. Kujdeset për zbatimin e vendimeve dhe rregulloreve në fuqi.

Përgjegjësi Kryesor Financiar

Neni 29

1. Propozimet për Përgjegjësin Kryesor Financiar të PLE-së bëhen nga Kryetari i PLE-së dhe anëtarët e Kryesisë.
2. Përgjegjësi financiar zgjedhët dhe shkarkohet nga Kryesia.
3. PLE-ja mund të ketë deri në dy asistentë të financave të cilët do të kenë të drejtë të kontrollojnë xhirollogarinë bankare në çdo kohë por pa të drejtë të tërheqjes, pagesave apo të transfereve të mjeteve financiare.
4. Të drejtën e kontrollit të xhirollogarisë bankare, pa të drejtë të kryerjes së transaksioneve apo të tërheqjes së mjeteve financiare e ka edhe Nënkryetari për Diasporë.
5. Puna e përgjegjësit të financave përcaktohet me rregullore të veçantë.
6. Përgjegjësi i përgjithshëm financiar shqyrton çështjet financiare të degëve dhe krijon sistemin e raportimit periodik;
7. Përgjegjësi financiar raporton në çdo kohë para Kryetarit, Kryesisë dhe Kuvendit.
8. Përgjegjësi financiar është i obliguar të zbatojë në tërësi planin e buxhetit të miratuar në Kryesi.
9. Raportet financiare dhe të auditimit bëhen publike dhe janë të qasshme për të gjithë anëtarët e PLE-së.
10. Tërheqjet, pagesat, transferet dhe deponimet bëhen vetëm nga përgjegjësi financiar.
11. Shpenzimet me para të gatshme nuk mund të kalojnë shumë mbi 500 Euro brenda 24 orëve .
12. Çdo pagesë apo tërheqje mbi 500 Euro duhet të aprovohet edhe nga Sekretari.
13. Të gjitha pagesat me vlerë mbi 100 Euro kryhen me transfer bankar.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Përgjegjësit Kryesor Financiar

Neni 30

1. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Përgjegjësit Kryesor Financiar janë si në vijim:
 - a. Menaxhon llogarinë bankare dhe mbahet përgjegjës për mjetet e deponuara në xhirollogarinë bankare;
 - b. Përdorë xhirollogarinë bankare dhe delegon përgjegjësi të monitorimit të qarkullimit bankar asistentëve të tij, pa të drejtë të kryerjen së transaksioneve;
 - c. Menaxhon me pronën dhe pasurinë e PLE-së dhe të ndarjes së burimeve financiare nëpër degë, në koordinim me Sekretarin;
 - d. Paraqet para Kryesisë dhe kryetarëve të degëve raportet financiare tremujore dhe vjetore;
 - e. Jep informata shtesë në secilën kohë që kërkohen nga Kryetari, Kryesia dhe kryetarët e degëve;
 - f. Nënshkruan për çështje financiare në emër të partisë dhe në bazë të autorizimeve që ka;
 - g. Publikon dhe mbanë të publikuar të paktën për një vit Raportin Vjetor Financiar, në ueb faqen zyrtare të PLE-së;

Marrëdhëniet me Publikun

Neni 31

1. Organet e PLE-së informimin e anëtarëve dhe të opinionit të gjerë e realizojnë në pajtim me rregullat dhe parimet e informimit në kohë.
2. Kryetari i PLE-së emëron një Zëdhënës për media dhe Marrëdhënie me publikun.
3. Zëdhënësi për media dhe Marrëdhënie me publikun vepron në koordinim dhe sipas autorizimeve të Kryetarit të PLE-së.
4. PLE për komunikim me publikun realizon dhe zbaton:
 - a. Komunikata për media;
 - b. Konferenca për shtyp;
 - c. Tryeza të rrumbullakëta;
 - d. Seminare;
 - e. Krijon dhe mirëmban Ueb faqe;
 - f. Shfrytëzon dhe mirëmban rrjetet sociale zyrtare të partisë;
 - g. Komunikoni përmes mediave lokale dhe qendrore;
 - h. Publikon raporte.

Shtabi Zgjedhor

Neni 32

1. Shtabi Zgjedhor krijohet me propozim të Kryetarit dhe me vendim të Kryesisë.
2. Shtabi zgjedhor përbëhet prej shtatë anëtarëve.

3. Kryesia zgjedh udhëheqësin e Shtabit Zgjedhor në mesin e anëtarëve të shtabit.
4. Mandati i shtabit zgjedhor është konform me vendimin e paragrafit një të këtij Neni.

Instituti Hulamtues i PLE-së

Neni 33

1. Institucion i veçantë i PLE-së është Instituti Hulamtues.
2. Instituti Hulamtues ka Bordin mbikëqyrës i cili zgjedhet dhe shkarkohet me vendim të Kryesisë së PLE-së.
3. Instituti Hulamtues ka Drejtorin Ekzekutiv, të cilin e zgjedh dhe shkarkon Bordi.
4. Instituti ka stafin profesional i cili përzgjedhjet në bazë të kritereve për kryerjen e detyrave të përcaktuara.

Neni 34

1. Instituti Hulamtues merret me:
 - a. Promovimin e kulturës së komunitetit egjiptian;
 - b. Kryen hulumtime dhe analiza politike, sociale dhe kulturore në interes të komunitetit egjiptian dhe qytetarëve të Kosovës pa dallim;
 - c. Siguron fonde për realizmin e objektivave të veta;
 - d. Kryen veprimtari botuese;
2. Instituti përcjell analizon, harton projekte, studion politikat dhe të gjitha aktet ligjore me rendësi për jetën shoqërore, ekonomike, politike, sociale, kulturore, arsimore, shkencore, shëndetësore, të mbrojtjes dhe të sigurisë dhe të sportit në Kosovë.
3. Përgatitë projekt-propozime, për ndryshime dhe plotësime të aktiviteteve të caktuara brenda partisë të parapara sipas të gjitha akteve të brendshme.

VIII. PËRFAQËSIMI I GRAVE DHE TË RINJËVE

Grupi i grave

Neni 35

1. Grupi i grave të PLE-së përbëhet nga të gjitha gratë e përfaqësuara në Kryesinë e PLE-së.
2. Grupi ka për qëllim të artikuloj kërkesat e të gjitha grave anëtare të PLE-së dhe ti paraqes ato para organeve vendimmarrëse. Të promovojë pjesëmarrjen e grave në politikë, edukimin dhe rritjen e kapaciteteve të tyre.

3. Grupi i grave ka Kryesuesen e vet, e cila zgjedhet në mesin e anëtareve të grupit me shumicë të votave.
4. Mandati i Kryesueses zgjatë 4 vite, me të drejtë të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.
5. Procedurat për shkarkimin e Kryetares mund të iniciohen me nënshkrimet e 1/3 të anëtarëve të grupit.
6. Shkarkimi mund të bëhet me shumicën e votave të anëtareve të grupit.

Grupi i të rinjve

Neni 36

1. Grupi joformal i të rinjve të PLE-së përbëhet nga të gjithë të rinjtë e përfaqësuar në Kryesinë e PLE-së.
2. Grupi ka për qëllim të artikuloj kërkesat e të gjithë të rinjve anëtarë të PLE-së dhe ti paraqes ato para organeve vendimmarrëse. Të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve në politikë, edukimin dhe rritjen e kapacitete të tyre.
3. Grupi i të rinjve ka Kryesuesin e vet, i cila zgjedhet në mesin e anëtarëve të grupit me shumicë të votave.
4. Mandati i Kryesuesit zgjatë 4 vite, me të drejtë të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.
5. Procedurat për shkarkimin e Kryetarit mund të iniciohen me nënshkrimet e 1/3 të anëtarëve të grupit.
6. Shkarkimi bëhet me shumicën e votave të anëtareve të grupit.

IX. FINANCIMI DHE AUDITIMI

Mjetet financiare

Neni 37

1. Burimet financiare të PLE-së realizohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e tjera juridike të brendshme. Të ardhura përfshijnë:
 - a. Kuotat e anëtarësisë;
 - b. Donacionet prej personave fizik dhe juridik;
 - c. Granti nga buxheti i shtetit i akorduara për mbështetje të subjekteve politike;
 - d. Ushtrimi i veprimtarive fitimprurëse.

2. PLE paguan sipas kontratës së punës për anëtarët që kryejnë punë në organet e saj.
3. Ndarja dhe shpenzimi i mjeteve bëhet me rregullore të posaçme të cilat i miraton Kryesia.
4. PLE ka vetëm një xhirollogari bankare.
5. Degët e PLE-së mund të kenë nën-llogari bankare, në kuadër të llogarisë kryesore të PLE-së.
6. Kryetari i PLE-së nuk ka të drejtë të përdor, menaxhoj, tërheqë, bëjë pagesa apo të transferoj nga xhirollogaria bankare.
7. Të drejtë në përdorimin e xhirollogarisë ka vetëm përgjegjësi financiar i autorizuar.

Auditimi

Neni 38

1. PLE mund të themeloj komision të brendshme të auditimit, përbërjen e së cilit e miraton Kryesia e PLE-së pas propozimit të Kryetarit.
2. Komisioni përbehet nga 5 ekspertë.
3. Komisioni e kontrollon veprimtarinë e financave dhe të kontabilitetit ku shtrihet partia me degët e saj brenda vendit dhe jashtë saj.
4. Komisioni i auditimit raporton para Kryesisë së PLE-së.
5. Auditimi mund të bëhet edhe nga kompani jashtë partisë sipas nevojës.
6. PLE i nënshtrohet edhe auditimit të jashtëm të parapara me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

X. PËRFAQËSIMI NË INSTITUCIONE

Neni 39

1. Kandidat për Anëtarë të Kuvendit Komunal mund të jetë çdo anëtarë i PLE-së në degën përkatëse, që propozohen nga nëndegët dhe degët. Listën përfundimtare të kandidatëve e vendos Kryesia e Degës.
2. Anëtarët e Kuvendit Komunal të zgjedhur nga radhët e PLE-së, raportojnë për punën e tyre në Kryesi të Degës përkatëse, të paktën një herë në vit.

Neni 40

1. Propozimet për kandidatë për kryetar të komunës ka të drejtë të bëjë secila nëndegë dhe Kryesia Qendrore e PLE-së.
2. Pas shqyrtimeve të kandidaturave në Kryesi të Degës, përmes votimit me shumicë të votave të anëtarëve prezent, Kryesia vendos për kandidatin për Kryetar të Komunës.
3. Kryetarët dhe Nënkryetarët e zgjedhur të Komunave nga radhët e PLE-së, raportojnë për punën e tyre në Kryesi të Degës përkatëse, të paktën një herë në vit.

Neni 41

1. Secila degë e PLE-së propozon jo më pak se pesë kandidatë për listën për deputetë, të cilët miratohen në Kryesi të Degës pas propozimeve të nëndegëve dhe degëve.
Secila njësi e PLE-së propozon më së paku një kandidat për listën për deputet.
2. Listën përfundimtare të kandidatëve për deputetë e vendos dhe plotëson me emra të tjerë Kryesia e PLE-së.
3. Deputetët e zgjedhur nga radhët e PLE-së, të paktën një herë në vit raportojnë për punën e tyre në Kryesi të PLE-së.

Neni 42

1. Përmes një vendimi të veçantë, Kryesia e PLE-së vendos për përcaktimin e kriterëve për përfaqësimin e PLE-së në institucionet publike.
2. Në bazë të plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, Kryesia vendos për plotësimin e pozitave për përfaqësim e PLE-së në institucionet publike.
3. Të gjithë personat që mbajnë pozita publike të emëruar nga radhët e PLE-së, raportojnë për punën e tyre në Kryesi të PLE-së të paktën një herë në vit.
4. Kryesia e PLE-së vendos për shkarkimin dhe zëvnedësimin e të gjitha pozitave që përfaqësojnë PLE-në në institucionet publike.

XI. ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Komisioni i Etikës

Neni 43

1. Komisioni i Etikës përbehet prej dhejtë anëtarëve.
2. Secila degë e PLE-së ka të drejtën e delegimit të një përfaqësuesi në komisionin e Etikës, të cilët preferohet të jenë me profesion jurist.
3. Mënyra e funksionimit dhe fushëveprimi i Komisionit rregullohet me rregullore të veçantë.

XII. KUSHTET NË TË CILAT PUSHON VEPRIMTARIA E PLE-SË

Neni 44

1. PLE-ja mund të pushojë së ekzistuari nëse për këtë vendosin 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të PLE-së.
2. PLE-ja mund të bashkohet apo të shkrihet në ndonjë subjekt tjetër politik dhe anasjelltas, nëse për këtë votojnë 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të PLE-së.
3. Në rast të shuarjes apo shpërbërjes së PLE-së nga pika 1 e këtij Neni, së pari përmbushen të gjitha detyrimet financiare ndaj kreditorëve, kurse pjesa e mjeteve të mbetura do të shpërndahet tek organizatat humanitare që veprojnë në Kosovë dhe që kanë për mision t'i ndihmojnë komunitetit Egjiptian.

XIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 45

1. Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Statuti bëhet sipas procedurave të parapara për miratim.
2. Propozimet për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit mund të bëjë Kuvendi i PLE-së, Kryesia dhe Kryetari.
3. Ndryshimet për plotësimet në organet e PLE-së mund të bëhen me votim të hapur me pesëdhjetë plus një (50%+1) të anëtarëve të organit përkatës, nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Statut.
4. Interpretimin autentik të këtij Statuti e bënë Kuvendi i PLE-së.
5. Shpjegimet për ndryshimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij Statuti i jep Komisioni Statuar.
6. Tekstin e spastruar të Statutit dhe aktet e tjera të PLE-së i ruan Sekretari i përgjithshëm dhe Komisioni Statutar.
7. Te gjitha aktet e cekura në këtë Statut duhet të miratohen brenda periudhës prej gjashtë muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Neni 46

1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i PLE-së.
2. Çdo rregullore, vendim dhe akt tjetër individual duhet t'i përmbahet këtij Statuti.